

Vendim nr. 26, datë 23.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Ilir Toska, Anëtar
Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 23.01.2026 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 22 (D) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

DEAR MUÇA

OBJEKTI:

Fillimi i procedimit disiplinor sipas ligjit për shkelje të rënda profesionale dhe etike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për mosushtrimin e funksionit në përputhje me ligjin.

BAZA LIGJORE:

Nenet 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 147/c dhe 147/e e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*) me kërkesë, duke u ankuar për veprimtarinë e gjyqtarit E.M., gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përkatësisht për dy vendime të dhëna prej tij, një në vitin 2018 dhe tjetri në vitin 2021. Po kështu, kërkuesi është ankuar edhe për gjyqtaren A.A., gjyqtare në Gjykatën

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2021, e cila ka shqyrtuar kërkesën e tij për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarit E.M., si dhe ndaj gjyqtarës B.H., gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi, sipas tij, kjo e fundit nuk ka marrë në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë. Këto ankime të kërkuarit janë bashkuar nga ILD-ja, për shkak se i përkisnin të njëjtit ankues dhe se pretendoheshin të njëjtat fakte. Për rrjedhojë, nga ILD-ja është bërë trajtimi i përbashkët i tyre.

2. Në lidhje me ankesat e mësipërme, ILD-ja, me vendimet nr. 976/1 prot., datë 14.04.2025 dhe nr. 976/10, datë 10.06.2025, ka vendosur arkivimin e tyre. Ndaj këtyre vendimeve ka bërë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor (*KLGG*) kërkuar.

3. *KLGG*-ja, me vendimet nr. 17, datë 20.05.2025 dhe nr. 36, datë 25.08.2025, ka vendosur refuzimin e ankimeve të kërkuarit, si të pabazuara.

4. Në datën 05.11.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuar ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), me objekt fillimin e procedimit disiplinor sipas ligjit për shkelje të rënda profesionale dhe etike nga ILD-ja, *KLGG*-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*KLP*), për mosushtrimin e funksionit në përputhje me ligjin, i cili është regjistruar në datën 20.11.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

5. **Kërkuar**, ka pretenduar se ILD-ja dhe *KLGG*-ja kanë shkelur parimet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, duke shmangur qeverisjen e bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe eficiencës. ILD-ja ka shkelur ligjin dhe nuk ka respektuar afatet e inspektimeve. Po kështu, këto organe kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, duke kryer shkelje profesionale dhe etike, pasi kanë vepruar me neglizhencë të rëndë në ushtrimin e detyrave, nuk kanë respektuar haptazi ligjin, kanë kryer veprime të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, si dhe nuk u janë referuar fakteve. ILD-ja dhe *KLGG*-ja duhet të merrnin masa disiplinore ndaj gjyqtarëve për të cilët ishin bërë ankimet, pasi sjellja e tyre përmban të gjitha elementet e shkeljeve disiplinore. *Gjykata* dhe Kuvendi duhet të ngrenë komisione, sipas parashikimeve kushtetuese, për marrjen e masave për shkarkim ndaj përgjegjësve të ILD-së, *KLGG*-së dhe *KLP*-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës

6. Kolegji vëren se kërkuar i është drejtuar Gjykatës për fillimin e procedimit disiplinor, për shkelje të rënda profesionale dhe etike nga ILD-ja, si dhe nga anëtarët e *KLGG*-

së e të KLP-së, pasi, sipas tij, ata nuk kanë ushtruar funksionin në përputhje me ligjin. Për këtë arsye, Kolegji fillimisht do të analizojë verifikimin e juridiksionit kushtetues, duke qenë se çështja lidhet me juridiksionin disiplinor të anëtarëve të ILD-së, KLGJ-së dhe të KLP-së.

7. Gjykata ka pohuar se neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Kjo, pasi neni 131 i Kushtetutës, që përcakton kompetencat kryesore të saj dhe neni 134, që përcakton subjektet që e vënë në lëvizje, nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Kolegji konstaton se me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, neni 147/c, pika 2, i Kushtetutës, ka parashikuar se anëtari i KLGJ-së shkarkohet nga Gjykata kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, ose kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. I njëjti parashikim gjendet dhe në nenet 147/e, pika 2 dhe 149/b, pika 2, të Kushtetutës, për ILD-në dhe anëtarin e KLP-së. Megjithatë, neni 179, pika 7, fjalia e parë, i Kushtetutës, që përbën dispozitë kalimtare të ndryshimeve kushtetuese, ka parashikuar se për një periudhë të përkohshme prej nëntë vjetësh nga ngritja e institucioneve të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, kompetenca për shqyrtimin e këtyre lloj ankimeve ushtrohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) dhe jo nga Gjykata. Ndërsa sipas pikës 5, fjalia e dytë, të nenit 179/b, po të Kushtetutës, Gjykata gjatë periudhës kalimtare 9-veçare do të funksionojë me dy kolegje, një prej të cilave është KPA-ja.

9. Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se gjatë periudhës kalimtare të ndryshimeve kushtetuese, në të cilën ushtron mandatin KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe vetëm në përfundim të mandatit kushtetues të saj juridiksioni disiplinor sipas nenit 140, pika 4, të Kushtetutës, do të ushtrohet nga Gjykata (*shih vendimin nr. 36, datë 24.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Mbi bazën e parashikimeve dhe të standardeve kushtetuese të mësipërme, Kolegji vëren se organi që ka kompetencën për të shqyrtuar dhe vendosur përfundimisht për ankimet kushtetuese ndaj ILD-së, si dhe ndaj anëtarëve të KLGJ-së e KLP-së, duke u dhënë përgjigje edhe pretendimeve me natyrë kushtetuese, është KPA-ja. Kjo do të thotë se Gjykata nuk ka kompetencë për shqyrtimin e këtyre lloj ankimeve. Vendimi i dhënë nga KPA-ja, e cila është

një prej dy kolegjeve të Gjykatës, është pjesë e juridiksionit disiplinor të saj dhe është përfundimtar në rendin juridik të brendshëm.

11. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se shqyrtimi i ankimit të kërkuarit për fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të rënda profesionale dhe etike nga ILD-ja, si dhe nga anëtarët e KLGJ-së e të KLP-së nuk është në kompetencën e Gjykatës. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesa e kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.